



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.132/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesat e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Gjakovë, për shkak të vendosjes së banerave mbi rrugë publike të kandidatit për kryetar komune nga ky subjekt politik, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohen si të bazuara ankesat e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Gjakovë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 850.00 (tetëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbaramit**.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL. Anr. 132/2017, ZL. Anr. 133/2017 të datës 06.10.2017 dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL. Anr. 132/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të dy ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendohet se në fshatin Rogovë të Gjakovës mbi rrugë publike janë vendosur baneri i Ramadan Hotit kandidat për kryetar komune nga nga subjekti politik PDK. Me këtë rast parashtruesit e ankesave theksojnë se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së.

Parashtruesit e ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 07.10.2017, subjekti politik PDK thekson se shkeljet nuk janë të qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, dhe se me të njoftuar me ankesat kanë ndermar masat permisuese duke i larguar banerat nga vendi ku ka qene të vendosura. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se kanë ndërmmara masa evituese duke i larguar banerin nga vendi ku kanë qenë të vendosura.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

Ankesat janë të bazuara

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për kryetar komune nga radhët e subjektit politik PDK është vendosur mbi rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve, dhe slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugët publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për kryetar komune nga subjekti politik PDK, është vendosur mbi rrugë publike, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik PDK në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2017

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik PDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti baneri i kandidatit për kryetar komune nga ky subjekt politik është vendosur mbi rrugë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërruar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë larguar banerin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.132/2017 më datën 10.10.2017.



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*